



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 369/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi, Kryesues, Adnan Konushevi dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e parashtruar nga kandidati për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, Hendrit Bardheu, nga koalicioni PDK-AAK-NISMA, me seli në Klinë, paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 29.06.2017, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 01.07.2017, mori këtë:

## VENDIM

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e parashtruar nga Hendrit Bardheu, kandidat për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga koalicioni PDK-AAK-NISMA, me seli në Klinë.

### Arsyetim

PZAP-i, me datën 30.06.2017 në ora 10:55, ka pranuar një ankesë nga Hendrit Bardheu kandidat për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga koalicioni PDK-AAK-NISMA, në të cilën në ankesën thekson se ju është keqpërdor vota në Komisionin Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) e Klinës një ditë pas zgjedhjeve. Parashtruesi i ankesës pretendon se më 12 qershor në vendvotimin 0811C/01R nuk ka pas asnjë votë për numrin 106 të koalicionit PAN,.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimor, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### ankesa është e pabazuar

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara ngase parashtruesja e ankesës nuk ka ofruar asnjë dëshmi për ti vërtetuar pretendimet ankimore edhe pse barra e te provuarit bie mbi parashtruesen e ankesës, po ashtu nuk ka dhënë asnjë udhëzim apo hollësi se ku mund të gjenden dëshmitë, të cilat nuk i ka pasur në posedim lidhur me atë çka pretendon në ankesë. Ndërsa provat e parashtruara në ankesë sipas vlerësimit të PZAP-it, nuk paraqesin referencë ligjore në mbështetje të pretendimeve në ankesë e as bazë të vlefshme ligjore për marrjen e vendimit më të favorshëm për ankuesen.

Prandaj, PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmime konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në ankesë, konstaton se ankesa në fjalë është e pabazuar dhe e pa argumentuar dhe si të tillë ankesën e ankuesit e refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.369/2017 më datën 01.07.2017.

Kryesuesi i Panelit  
Fejzullah Rexhepi



***Udhëzim Juridike:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*